

SHTOJCA NR. 4 – FTESE PËR APLIKIM

Nr. RC-17/3 Prot.

Durrës, më datë 25.11.2025

FTESE PËR APLIKIM

Pozicioni: Lehtësues Terreni Nr. 1 dhe Lehtësues Terreni Nr. 2

E-mail:

durresiaktiv@gmail.com

Afati i dorëzimit të aplikimeve:

10.12.2025, ora 23:59

Qendra “Durrësi Aktiv”, në kuadër të zbatimit të projektit “Lumenj të pastër – dete të pastër (RIVERCLEAN)”, mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar përmes Milieukontakt Shqipëri, fton kandidatët e interesuar të aplikojnë për procedurën e përzgjedhjes së:

“2 Lehtësuesve të Terrenit për Projektin #IshemPaPlastike”.

Hapja e aplikimeve do të realizohet në datën 12.12.2025, ora 10:00, në ambientet e Qendrës “Durrësi Aktiv”, Durrës.

Kandidatët e interesuar janë të lutur të paraqesin aplikimin e tyre sipas kërkesave të mëposhtme.

I. KRITERET E PËRGJITHSHME DHE TË VEÇANTA PËR KUALIFIKIM

A. KRITERET E PËRGJITHSHME PËR KUALIFIKIM

1. Kandidati duhet të paraqesë Curriculum Vitae (CV) të përditësuar.
2. Kandidati duhet të paraqesë Ofertë Financiare për pozicionin për të cilin aplikon.
3. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të skualifikojë kandidatin dhe të vazhdojë procedurën me kandidatin pasardhës nëse rezulton se:

a) nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në Termat e Referencës;

b) nuk paraqet njërin ose disa nga dokumentet e kërkuara;

c) nuk përgjigjet brenda afateve të përcaktuara për realizimin e procedurës;

d) nuk dorëzon dokumentacionin brenda afateve të përcaktuara.

4. Dokumentacioni i kërkuar duhet të dorëzohet në adresën elektronike: durresiaktiv@gmail.com ose në adresën postare të organizatës.

B. KRITERET E VEÇANTA PËR KUALIFIKIM

1. Përshkrimi i Shërbimit

Ky shërbim ka për qëllim angazhimin e 2 (dy) Lehtësuesve të Terrenit për mbështetjen e zbatimit të projektit #IshemPaPlastike.

Lehtësuesi i Terrenit Nr. 1 – Koordinim me Bizneset HoReCa dhe Zbatimi i Metodologjisë HAPI (41 ditë pune) Do të jetë përgjegjës për:

- Identifikimin dhe hartëzimin e bizneseve HoReCa;
- Kontaktimin dhe mobilizimin e bizneseve;
- Administrimin e pyetësorëve HAPI;
- Asistimin në hartimin e planeve të reduktimit të plastikës;
- Monitorimin e progresit të bizneseve;
- Raportimin periodik të rezultateve.

Lehtësuesi i Terrenit Nr. 2 – Mobilizim Komunitar, Monitorim dhe Dokumentim (41 ditë pune) Do të jetë përgjegjës për:

- Organizimin e aktiviteteve të ndërgjegjësimit publik;
- Dokumentimin fotografik dhe narrativ të aktiviteteve;
- Mbledhjen e të dhënave në terren;
- Mbështetjen e aktiviteteve të pastrimit;
- Përgatitjen e raporteve mujore;
- Mbështetjen e eventeve publike të projektit.

2. Kriteret e Kualifikimit

3. Kandidati duhet të zotërojë diplomë universitare ose të jetë në përfundim të studimeve në fusha të lidhura me Shkencat Sociale, Shkencat Mjedisore, Zhvillimin Komunitar, Menaxhimin e Biznesit, Sociologjinë ose fusha të ngjashme.
4. Kandidati duhet të ketë minimumi 2 (dy) vite përvojë në aktivitete komunitare, projekte sociale, mjedisore ose në punë të drejtpërdrejtë me komunitetin.
5. Kandidati duhet të paraqesë Curriculum Vitae (CV) të përditësuar.
6. Kandidati duhet të paraqesë Ofertë Financiare.
7. Kandidati duhet të ketë aftësi të mira komunikimi, organizimi dhe bashkëpunimi.
8. Kandidati duhet të ketë njohuri bazë në Microsoft Office dhe Google Workspace.
9. Kandidati duhet të ketë aftësi në mbledhjen, sistemimin dhe raportimin e të dhënave.
10. Kandidati duhet të konfirmojë disponueshmërinë për realizimin e 41 ditëve të punës.
11. Kandidatët që disponojnë patentë drejtimi Kategoria B do të konsiderohen me përparësi.
12. Përvoja paraprake në projekte të financuara nga Bashkimi Evropian ose organizata të ngjashme do të konsiderohet avantazh.

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Nr	Përshkrimi i Shërbimit	Njësia	Sasia	Çmimi/Njësi pa TVSH (Euro)	Vlera Totale pa TVSH (Euro)	Afati i realizimit
1	Lehtësues Terreni Nr. 1 – Koordinim me Bizneset HoReCa dhe	Kontratë	1	_____	_____	41 ditë pune

	Zbatimi i Metodologjisë HAPI					
2	Lehtësues Terreni Nr. 2 – Mobilizim Komunitar, Monitorim dhe Dokumentim	Kontratë	1	_____	_____	41 ditë pune
	TOTALI PA TVSH				_____	

II. KRITERI PËR VLERËSIMIN E APLIKIMEVE

1. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të skualifikojë kandidatin e renditur i pari nëse:

- nuk plotëson kriteret e kërkuara;
- nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar;
- nuk konfirmon disponueshmërinë;
- nuk dorëzon dokumentacionin brenda afatit.

2. Kandidatët do të vlerësohen sipas sistemit të pikëzimit:

- Përvoja e përgjithshme në terren – 30%
- Përvoja në projekte mjedisore ose HoReCa – 25%
- Aftësitë teknike në mbledhjen e të dhënave dhe dokumentim – 20%
- Motivimi dhe disponueshmëria – 15%
- Përvoja paraprake me projekte/organizata të ngjashme – 10%

3. Kandidati që arrin rezultatin më të lartë total do të renditet i pari për përzgjedhje.

4. Kontrata do të lidhet brenda 5 (pesë) ditëve pune pas njoftimit të kandidatëve fitues.

5. Kandidatët duhet të paraqesin:

- Curriculum Vitae (CV);
- Ofertë Financiare;
- Dokumente ose referenca që provojnë eksperiencën profesionale të deklaruar.

6. Kandidatët që plotësojnë kriteret dhe arrijnë rezultatin më të lartë do të njoftohen për nënshkrimin e kontratës.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

DREJTOR EKZEKUTIV

Klaudio Hyseni